



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.524/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. H. nga Republika e Shqipërisë, me vendqëndrim në P., të cilin e përfaqëson Avokati Mehdi Geci, Zyra e Avokatisë Legalis Law, P., kundër të paditurës A. H. K., Sh.p.k., me seli në H., të cilën e përfaqëson avokati Virtyt Ibrahimaga nga P., për shkak të anulimit të vendimit, kthimit në punë dhe kompensimit të ardhurave, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10677/2021 datë 16.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29.11.2024, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit, A. H., nga Republika e Shqipërisë, me vendqëndrim në P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10677/2021 datë 16.02.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10677/21 të dt.16.02.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.66/2015 dt.18.05.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të “ anulohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës, nr.0482 dt.1.12.2014, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të detyrohet e paditura, që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës apo në vend tjetër të punës i cili i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, si dhe të ia kompensojë pagat neto për periudhën prej 2.12.2014 e deri 31.01.2020, në shumën prej 2,427.81 euro, kontributet pensionale

shumën prej 5.26 euro, si dhe tatimin në pagë në shumë prej 848.72 euro, të gjitha me kamatë ligjore nga data 5.03.2021 e deri në datën e pagesës së kompensimit. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet paditësi, që të paditurës të ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 509.60 euro, në afat prej 7 ditësh pasi ky vendim të merr formën e prerë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak shkeljes së Ligjit Për Procedurën Kontestimore (neni 214 i LPK-së, pa i specifikuar shkeljet) dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të pranohet si i bazuar revizioni i paditësit dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë, dhe çështja të dërgohet për rigjykim.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi më dt.12.01.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër së paditurës, për shkak të anulimit të vendimit të paditurës si i kundërligjshëm, kthimit në punë, dhe kompensimit të ardhurave personale, për periudhën kontestuese përkatëse dhe me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë gjeti se nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura sipas kontratës së punës të dt.20.09.2013, për kohë të pacaktuar, në pozitën e receptionistit. Nga vërejtja e shqiptuar me gojë, e përpiluar me shkrim më dt.15.11.2013, nga e paditura, konstatoi se paditësit, për shkak të neglizhencës së punës, duke mos i respektuar urdhrat e eprorit të tij, duke mos shënuar numrat e telefonit të pacientëve, duke ngatërruar ditët e vizitave të tyre, si dhe duke mos u identifikuar si person përgjegjës mbi gabimet e bëra, e paditura ia ka komunikuar vërejtjen me gojë, e cila është përpiluar në formë të shkruar, duke paralajmëruar paditësin se në rast të përsëritjes konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, ndaj tij do të ndërmerren masa të mëtejshme. Kësaj vërejtje të shqiptuar i ka paraprirë e-maili

zyrtar i të paditurës dt.15.11.2013, në të cilin ishin konstatuar të gjeturat lidhur me parregullsitë e sipër cekura, si në përmbajtjen e vërejtjes.

Po ashtu nga vërejtja e shqiptuar paditësit me shkrim dt.2.07.2014, nga e paditura, gjykata gjeti se paditësi duke i shkelur procedurat e punës në arkë dhe duke mos raportuar në nivelin përkatës të hierarkisë, duke mos u këshilluar dhe udhëzuar nga eprorët e tij, ka krijuar probleme financiare në Departamentin e Financave, si rrjedhojë e kësaj e paditura i ka shqiptuar paditësit vërejtjen me shkrim duke e paralajmëruar se në rast të përsëritjes, bazuar në dispozita ligjore të Ligjit të Punës, do të merren masa të mëtejshme ndaj tij, e kjo ka ardhur si shkas i e-mailit zyrtar i të paditurës dt.1.07.2014, në të cilin ishin konstatuar të gjeturat lidhur me parregullsitë e sipër cituara, si në përmbajtjen e vërejtjes së shqiptuar me shkrim. Nga vendimi i të paditurës nr.0482 dt.1.12.2014, del se të paditurit i ndërpritet marrëdhënia e punës duke filluar nga data 2.12.2014, në bazë të aktit të brendshëm të paditurës dhe në bazë të nenit 70 të Ligjit të Punës, për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, sepse deri në marrjen e atij vendimi paditësi gjatë dy muajve në pozitën e recepsionistit – arkë, ka bërë veprime të përsëritura dhe aspak të përgjegjshme çka ka kushtuar edhe në koston financiare të kompanisë, po ashtu vendimi është marrë duke u bazuar edhe në ankesat në vazhdimësi të eprorëve të tij për gabimet e pa tolerueshme të përsëritura, mos zbatim i detyrës dhe neglizhencës së treguar në arkë, të cilat janë adresuar dhe evidentuar në dosjen e punëtorit pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore të paditurës. E gjithë kjo parregullsi është mbështetur në e-mailat zyrtar të paditurës dt.12.09.2014 dhe 3.12.2014, lidhur me të gjeturat në të cilën janë konstatuar se gjatë kompletimit të dosjeve e paditura ka has në dosjen e pacientes e siguruar në Kompaninë e Sigurimeve “S.”, shërbimet janë faturuar në emër të Kompanisë edhe me zbritje, më dt.29.11.2014, mirëpo, kontrata e lidhur me Kompaninë e Sigurimeve kishte kohë që ka përfunduar me të paditurën.

Më tej, gjykata e shkallës së parë, nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara, gjeti se paditësi, deri në marrjen e vendimit nga e paditura, gjatë dy muajve, në pozitën e recepsionistit – arkë, ka bërë veprime të përsëritura dhe aspak të përgjegjshme, çka ka kushtuar edhe në koston financiare të paditurës dhe me shkeljet e specifikuar më lartë, i padituri ka bërë shkelje disiplinore, për çka i është shqiptuar nga e paditura më dt.15.11.2013, vërejtja me gojë, të hartuar edhe në formë të shkruar, duke e paralajmëruar paditësin se në rast të përsëritjes, ndaj tij do të merren masa të mëtejshme konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës. Po ashtu e paditura më dt.2.07.2014,

për shkak të gjeturave lidhur me veprimet e paditësit që i kishte ndërmarr në kundërshtim me procedurat e punës në arkë dhe duke mos raportuar në nivelin përkatës të hierarkisë, duke krijuar edhe probleme financiare për Departamentin e Financave, e paditura atij i ka shqiptuar edhe masën e dytë disiplinore, vërejtjen me shkrim, sërish me paralajmërimin përkatës si dhe me të dhënat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi që paditësi nuk ka arritur të provojë se vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës i të paditurës, është i kundërligjshëm, e me këtë as bazën ligjore për kompensimin e të ardhurave personale dhe se e paditura ka vendosur konform nenit 70 par.1 pika 1.4.2, nenit 85 të Ligjit të Punës si dhe konform nenit 2.1.2 të Aktit të Brendshëm të saj, prandaj, edhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, e njëjta ka vlerësuar se ankesa e paditësit është e pathemeltë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, kanë vendosur për refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit. Aktgjykimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndaj, pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, nuk mund ta vënë në dyshim aktgjykimin e goditur dhe si të tilla u konsideruan si të pathemelta. Gjithashtu, aktgjykimet e lartcekura, nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet nga revizioni.

Kështu, në kontekst të kësaj çështje juridike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 10.1 të Ligjit të Punës, parashihet se “ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji”, siç edhe është vepruar në rastin konkret, kur në të, me vullnetin reciprok, janë paraparë të

gjitha të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sikundër rrjedh nga provat e administruara, përkatësisht , nga shkresat e lëndës, e paditura në rastin konkret ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 70, nenit 85 etj, Ligjit të Punës, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 2, nenit 13, nenit 16 të Kontratës së punës (dt. 20.09.2013), si dhe në pajtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.2 të Aktit të Brendshëm të paditurës (2012). Këto dispozita parashohin, përkatësisht, rregullojnë rastet, konditat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të cilat në fakt, në rastin konkret civil – juridik, ishin përmbushur, sepse në mënyrën e sipër përmendur, veç tjerash, është vërtetuar fakti relevant për shkeljet e detyrave të punës nga ana e paditësit, (në mënyrë të përsëritur, siç u përshkrua më lartë) që kanë të bëjnë me përmbushjen e pakënaqshme të detyrave të punës dhe me një keq sjellje më pak serioze ose shkelje të detyrimeve. Në kontekstin e mësipërm, sipas dispozitës së nenit 70.1, nënp.1.6 shprehimisht përcaktohet se “ punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë, kur: siç parashihet në nënp.1.6.1. “ i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose shkeljes së detyrimeve”, përkatësisht, nënp.1.6.2 “ performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim”, sikundër edhe është provuar në rastin konkret civil dhe se e paditura përkitazi e këtë rast, ka vepruar në përputhje edhe me dispozitat e sipër përmendura ligjore.

Kështu, edhe me dispozitat e nenit 16 (pika 16.4) të kontratës së punës, dt.20.09.2013, veç tjerash, parashihet se, ” Punëdhënësi mund të ndërpresë menjëherë marrëdhënien e punës në çdo kohë dhe pa paralajmërim për shkaqe të arsyeshme sipas përkufizimit të kësaj kontrate, nëse punëmarrësi ka kryer një faj të rënd, ka shkelur ligjin, rregullat e sigurisë dhe cilësisë në punë, rregulloren e brendshme apo i ka shkaktuar një dëm të rënd punëdhënësit”. E kur jemi këtu duhet pas parasysh edhe nenin 2.1.1 dhe nenin 2.1.2 të Aktit të Brendshëm të paditurës (2012), ku veç tjerash, me nenin 2.1.1, të tij, parashihet se “ Shkeljet e parapara në par.1, nëse përsëriten, konsiderohen shkelje të rënda”. Prandaj, nga interpretimi i dispozitave të sipër përmendura, rezulton se në rast të shkeljeve të rënda nga punëmarrësi dhe sjelljes në kundërshtim me Kontratën e Punësimit apo rregulloret e organizatës, etj, Punëdhënësi, rezervon të drejtën ta sanksionojë me largim të menjëhershëm nga puna Punëmarrësin, pa paralajmërim. Prandaj, në kontekstin e mësipërm, e paditura hapin dhe vendimin e sipër përmendur, e ka ndërmarrë në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit, si dhe me dispozitat e kontratës së punës, të sipër përmendura.

Nga këtu, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Për arsyet e lartë cekura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.524/2024 dt.29.11.2024

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha